REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr3423 Prot. Tiranë, më 30.01.2025

URDHËR
Nr.3423, datë 30.01.2025

PËR
"MIRATIMIN E STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT 2025 - 2028, NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR"

Në mbështetje të nenit 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 15, pika 2, shkronja "e" të ligjit nr. 95/2016 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*", të ndryshuar, nenit 42, shkronja "f" të ligjit nr. 97/2016, "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative*",

URDHËROJ:

1. Miratimin e strategjisë së komunikimit 2025 - 2028, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Kabineti i Drejtuesit, Koordinatori për Marrëdhëniet me Mediat në Kabinetin e Drejtuesit të Prokurorisë dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin Dumani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË

SPAK
STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT 2025-2028

Misioni

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) ushtron ndjekjen penale në pavarësi të plotë të garantuar nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi. Ajo i kryen funksionet e saj përmes prokurorëve të posaçëm, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përputhje me ligjin dhe në bashkëpunim me hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), institucion në varësi të saj. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e cila përbehet nga Prokuroria e Posaçme dhe BKH synon të luftojë kulturën e pandëshkueshmërisë në Shqipëri, bazuar mbi standardet më të larta ndërkombëtare për hetimin e korrupsionit të zyrtarëve publikë, krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe terrorizmit.

PËRMBAJTJA

SHKURTIME 3
PARIMET E KOMUNIKIMIT 5
QËLLIMI 6
METODOLOGJIA 6
AUDIENCAT 9
TË DHËNAT NGA AUDIENCAT E NDRYSHME 9
PLANI I MASAVE 11
STANDARDET DHE PLANI I ZBATIMIT 16
MONITORIMI DHE VLERESIMI 18

SHKURTIME

SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
PV	Plani i Veprimit
TKP	Treguesit kryesorë të përformancës
PMK	Protokolli i menaxhimit të krizave
M&V	Monitorimi dhe vlerësimi
GCSI	Shërbimi i Komunikimit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar

HYRJE

Strategjia e Komunikimit 2025-2028 është një dokument thelbësor që do të mbështesë punën e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Komunikimi është element i rëndësishëm që do të ndihmojë në rritjen besimit të publikut tek një sistem drejtësie i pavarur, i cili garanton zbatimin e ligjit në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Strategjia e Komunikimit është një udhërrëfyes praktik për ta bërë komunikimin më të shpejtë dhe të kuptueshëm duke ndikuar në rritjen e transparencës, informimit dhe si rrjedhojë edhe besimit të publikut në sistemin gjyqësor.[1] Ky dokument përcakton parimet kryesore, angazhimet, mënyrën e zbatimit dhe matjen e ndikimit të tij.

Strategjia merr parasysh gjithashtu zhvillimet teknologjike, të cilat ecin me ritme të shpejta, krahas tyre me të njëjtën shpejtësi lëvizin kërkesa për informacion dhe transparenca. Prokuroria e Posaçme e konsideron komunikimin si një aspekt jetësor të funksionimit të saj. Duke kultivuar dialogun me qytetarët, median dhe grupet e interesit, Prokuroria e Posaçme synon të ruajë integritetin institucional, të inkurajojë punën e prokurorëve të posaçëm dhe aksesin e qytetarëve në drejtësi.

Korrupsioni dhe krimi i organizuar konsiderohen si faktorë që cënojnë rëndë themelet e shtetit ligjor. Ndër kushtet kryesore të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) është adresimi i tyre në mënyrë sa më efektive. Në këtë kontekst, komunikimi me publikun zë një vend të veçantë mbështetur në legjislacionin e brendshëm, si edhe në kornizën institucionale. Transparenca e institucioneve të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do t'u mundësonte qytetarëve të ushtronin të drejtën e tyre të kontrollit të punës së këtyre institucioneve dhe zbatimin prej tyre të ligjit.[2]

Shumë prej qytetarëve e shohin luftën kundër korrupsionit si një hap vendimtar për afrimin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Prokuroria e Posaçme aktualisht gëzon një nivel të lartë të besimit të qytetarëve duke dëshmuar përmes punës së saj, se në Shqipëri askush nuk është mbi ligjin. Veprimtaria e këtij institucioni është në qendër të vëmendjes, me pritshmëri të larta për

[1] Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë (CCPE). (2014). *Opinioni Nr. 9 i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë drejtuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Normat dhe Parimet Evropiane që Lidhen me Prokurorët.* Strasburg, 17 dhjetor 2014. paragrafi VII. Marrë nga https://rm.coe.int/168074738b

[2] Vurmo, G., Sulstarova, R., & Dafa, A. (2021). *Dekonstruktimi i kapjes së shtetit në Shqipëri: Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të madh dhe ligjeve të krijuara për qëllime të veçanta nga 2008 deri në 2020.* Instituti për Demokraci dhe Mbrojtjen e Mediave Transparency International. ISBN: 978-3-96076-170-9. Marrë nga https://idmalbania.org/ëp-content/uploads/2021/11/2021_Report_DeconstructingStateCaptureAlbania_English.pdf

rezultatet e tij[3]. Si pasojë, interesi i gazetarëve dhe medias për punën e Prokurorisë së Posaçme është shumë i madh dhe mund të paraqesë sfida për institucionin.

Prokuroria e Posaçme e konsideron shumë të rëndësishëm hartimin e një strategjie për komunikimin me publikun dhe median, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare dhe në përgjigje të rekomandimeve të BE-së[4] dhe Rezolutave të Kuvendit.[5] Përmes një plani të qartë komunikimi, Strategjia përcakton mënyrën si Prokuroria e Posaçme të jetë transparente dhe profesionale me publikun dhe gazetarët me qëllimin e vetëm konsolidimin e besimit të qytetarëve tek Sistemi i Drejtësisë në përgjithësi dhe tek puna e Prokurorisë së Posaçme, në veçanti.

PARIMET E KOMUNIKIMIT

- **TË DREJTË DHE TË EKUILIBRUAR** për të treguar se të gjithë qytetarët janë të barabartë përpara ligjit[6] dhe gëzojnë të drejtën e një procesi të rregullt ligjor.[7]

- **TRANSPARENT DHE LLOGARIDHËNËS** ndaj qytetarëve të cilëve u shërbejmë[8].

- **REAGUES** përmes një qasjeje të bazuar tek informimi i qytetarëve dhe i grupeve të interesit, duke dëgjuar dhe u përgjigjur të gjithë atyre që janë përballur me fenomenin e korrupsionit dhe janë cënuar nga krimi i organizuar dhe terrorizmi.

- **BASHKËPUNUES** duke e mbështetur luftën e gjerë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në vend dhe duke ndarë informacion dhe ekspertizë me qytetarët, median dhe institucionet e tjera shqiptare dhe ndërkombëtare, që luftojnë korrupsionin, krimin e organizuar

---

[3] *Fjalimi i Ambasadorit të BE-së në Shqipëri Silvio Gonzato në përvjetorin e pestë të SPAK, 19.12.2024,* Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Marrë nga https://ëëë.eeas.europa.eu/delegations/albania/fjalimi-i-ambasadorit-të-be-së-në-shqipëri-silvio-gonzato-në-përvjetorin-e-pestë-të-spak_sq?fbclid=IëZXh0bgNhZË0CMTAAAR2Y5iMRCmUzRs6unOMiD7Prm9Q62lvëUM4tntqsëNE9K_Ssh_2jRJL8rkc_aem_iNREz0B8MË6Vx6N_TkFPYg

[4] Raporti i shqyrtimit për Shqipërinë (*Screening Report Albania*) i Komisionit Evropian, 20 korrik 2023. Marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/doënload/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

[5] Rekomandimi nr. 6 i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022", 06 korrik 2023. Marrë nga https://spak.gov.al/ëp-content/uploads/2023/10/Rezoluta-e-Kuvendit-per-2023.pdf

[6] Kushtetuta, neni 18 paragrafi 1.

[7] Kushtetuta, neni 42.

[8] Kushtetuta, neni 23, paragrafi 1.

dhe terrorizmin[9].

QËLLIMI

Strategjia e Komunikimit trajton përparësitë e komunikimit për vitin 2025-2028, në funksion të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të këtij institucioni.

Prokuroria e Posaçme parashtron përparësitë e komunikimit përgjatë tre viteve të ardhshëm, si dhe mënyrën se si ky institucion do të komunikojë me gazetarët, median, qytetarët dhe grupet e interesit, lidhur me punën dhe funksionin e saj.

Zbatimi i kësaj strategjie do të ndihmojë:

- Të **përkushtohemi për transparencën** dhe komunikimin me qytetarët.
- Të ofrojmë **përditësime zyrtare për median dhe publikun.**
- Të krijojmë bashkëpunim **të qëndrueshëm** me gazetarët, median, institucionet e drejtësisë dhe shoqërinë civile.
- Të rrisim **informimin e publikut** dhe të përmirësojmë **besimin e qytetarëve** për institucionin në veçanti dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

Për hartimin e Strategjisë së Komunikimit, Prokuroria e Posaçme është mbështetur në perceptimin dhe intervistat me qytetarët, gazetarët, shoqërinë civile dhe punonjësit e sektorit publik në disa rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj pune kërkimore ishte për të pasur një panoramë më të gjerë të perceptimit dhe përvojës së qytetarëve shqiptarë në përballje me korrupsionin dhe krimin e organizuar, prirjes apo mundësisë së tyre për t'i denoncuar, rolit të Prokurorisë së Posaçme apo edhe nivelin e besimit tek institucionet e tjera shqiptare, të cilat janë gjithashtu përgjegjëse në luftën kundër tyre.

METODOLOGJIA

Kjo Strategji është përgatitur me ndihmën e ekspertëve të Shërbimit të Komunikimit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar (GCS) dhe ekpertëve të pavarur shqiptarë, të cilët kanë bërë një vlerësim të qasjes së Prokurorisë së Posaçme në marrëdhëniet me publikun, përmes intervistave me gazetarët që raportojnë punën e institucionit, si edhe me 8 grupe fokusi në disa qarqe, me qytetarë të moshave, gjinive, etnive, arsimit dhe profesioneve të ndryshëm, si edhe një pyetësor me një kampionim prej

[9] Ligji nr.95/2016 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*", të ndryshuar, neni 28.

1000 personash të moshës nga 18 vjeç e lart, me një marzh gabimi prej ±3,2%.
Për pyetësorin u përzgjodhën përfaqësues nga të gjithë shtresat e shoqërisë, përfshirë edhe nga minoritetet, duke ruajtur një balancë të drejtë përfaqësimi gjinor. Të dhënat u mblodhën gjatë periudhës korrik - gusht 2024. Për këtë qëllim, ekspertët dhe studiuesit e komunikimit e Shërbimit të Komunikimit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, GCSI bashkëpunuan me një agjenci të pavarur kërkimore shqiptare.

Tetë grupe fokusi në:

- Zonë urbane – Tiranë - të gjitha gjinitë, të gjitha moshat.
- Zonë urbane – Durrës - të gjitha gjinitë, mbi 30 vjeç.
- Zonë urbane – Shkodër - djem të rinj, mosha 18 - 30 vjeç.
- Zonë urbane – Fier - gra të reja, mosha 18 - 30 vjeç.
- Zonë rurale – Fier - të gjitha gjinitë, mbi 30 vjeç.
- Elbasan - Të gjitha gjinitë, mbi 50 vjeç.
- Finiq – Minoriteti Grek - të gjitha moshat.
- Fier - komuniteti Rom - të gjitha moshat, meshkuj.

Gjithashtu u zhvilluan pesë intervista të thelluara me punonjës të sektorit publik:

- Një punonjës në shërbimin shëndetësor - Tiranë
- Një punonjës në Policinë e Shtetit - Tiranë
- Një prokuror në Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm - Durrës
- Një drejtues në Ministrinë e Infrastrukturës - Durrës
- Disa specialistë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme - Durrës

Nga gjetjet u arrit në përfundimin se qytetarët e kuptojnë shumë mirë lidhjen mes krimit të organizuar dhe korrupsionit, por përvojat e tyre janë të ndryshme në varësi të moshës, vendndodhjes dhe etnisë.

Këto gjetje u ndanë në një seancë diskutimi me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme dhe 19 prokurorët e posaçëm, për t'i ndihmuar ata të kenë një informacion më të detajuar mbi përvojat e qytetarëve dhe mbi rëndësinë e komunikimit për punën që kryejnë apo progresin e arritur.

Prokuroria e Posaçme, përmes kësaj Strategjie, e cila shoqërohet edhe me **Planin e Veprimit (PV)** synon krijimin e një ure të fortë të komunikimit me publikun, duke u përqëndruar tek afatet e dhënies së informacioneve.

Treguesit Kryesor të Performancës (TKP) do të ndihmojnë në vlerësimin e progresit dhe përmbushjen e angazhimeve që rrjedhin prej tij. Për monitorimin e ecurisë do të zhvillohet edhe një anketë, çdo 3 (tre) muaj me një panel gazetarësh, që raportojnë mbi punën e SPAK-ut. Monitorimi,

vlerësimi dhe përvojat e marra janë elemente thelbësorë për ta bërë komunikimin e efektshëm dhe për t'i përdorur burimet njerëzore dhe infrastrukturën përkatëse në mënyrë efikase. Matja e ndikimit të komunikimit të Prokurorisë së Posaçme dhe komentet që do të japin gazetarët do të ndahen me Drejtuesin e këtij institucioni, prokurorët dhe grupet e interesit, për të garantuar kulturën e progresit të vazhdueshëm.

QASJA NË KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Besimi i publikut krijohet përmes rritjes së transparencës. Ndarja e arritjeve dhe sfidave të Prokurorisë së Posaçme do të ndihmojë në krijimin e qëndrimeve të mbështetura mbi informacione, të dhëna dhe fakte reale dhe jo në perceptime.

Për të arritur këtë qëllim:

1. Komunikimet e Prokurorisë së Posaçme do të jenë të **qarta**, të **shpejta** dhe të kuptueshme nga gazetarët, media dhe qytetarët, duke ulur ndjeshëm ndikimin e keqinformimit dhe komenteve apo qëndrimeve të pambështetura në fakte.

2. Do të **respektohen të drejtat** e individëve nën hetim dhe do të punohet me grupet e interesit, gazetarët dhe median për një balancë mes të drejtës për informim dhe ruajtjes së sekretit hetimor, në zbatim të ligjit dhe vendimeve të gjykatave.

3. Kanalet e komunikimit të Prokurorisë së Posaçme do të kthehen në **burime të besuara informacioni** për qytetarët, me përditësime të shpejta dhe ndarjen e të dhënave me një numër sa më të gjerë të audiencave

4. Qytetarët do të kenë qasje të shpejtë në **informacionin e** publikuar në faqen e internetit dhe dy kanalet e mediës sociale të SPAK.

5. Do të **ndahen të dhëna të shpejta** dhe Prokuroria e Posaçme do të angazhohet me institucionet e tjera për përmirësimin e standardeve dhe ndarjen e praktikave më të mira në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri, me qëllimin për të kontribuar në përmirësimin e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

6. Prokuroria e Posaçme do të jetë më e **qartë me qytetarët për çështjet, subjektet dhe veprat penale që mund t'i denoncojnë dhe për ato që do të duhet t'i referohen prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm,** për t'i orientuar ata drejt institucioneve të duhura, si dhe për ruajtjen e besimit të tyre tek institucioni ynë i pavarur.

Adresa: Rruga "Jordan Misja" nr.1 Tiranë Website: www.spak.gov.al

7. Do të **komunikojmë në mënyrë proaktive dhe periodike** gjatë situatave të krizës, do të vijojmë të jemi një burim i besuar informacioni, duke pakësuar kësisoj ndikimin e narrativave të dëmshme në media.

8. Do të **monitorohet dhe vlerësohet efektshmëria** e komunikimeve përmes protokolleve specifikë, me qëllim reflektimin në kohë të formave të komunikimit me publikun.

AUDIENCAT

Mesazhi kryesor: Forcimi i transparencës dhe komunikimit me qytetarët do të kthejë besimin tek një sistem drejtësie i pavarur, i cili mbështetet mbi parimin: "Të gjithë të barabartë para ligjit"

Audienca duhet të jete në qendër të komunikimeve të Prokurorisë së Posaçme. Për të pasur një komunikim të efektshëm është thelbësore të kuptohen llojet e ndryshme të audiencës.

Media është partner shumë i rëndësishëm, e cila lidh Prokurorinë e Posaçme me qytetarët. Mbështetur mbi statistikat, 75% e popullsisë së Shqipërisë sheh televizion çdo ditë, ose thuajse çdo ditë.

Në qendër të kësaj strategjie qëndron komunikimi i efektshëm i veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme. Mënyra se si qytetarët i kuptojnë punët dhe sfidat e institucionit mbetet jetësore për konsolidimin e besimit të tyre.

Për këtë qëllim, komunikimi është një mjet i rëndësishëm, që do të vendosë themelet e një marrëdhënieje ndërveprueese mes institucionit, qytetarëve, gazetarëve, medias dhe grupeve të interesit.

TË DHËNAT NGA AUDIENCAT E NDRYSHME

1. **Qytetarët në Shqipëri besojnë se fenomeni i korrupsionit mund të reduktohet duke shënuar progres në këtë drejtim.**
2. **Ndërgjegjësimi lidhur me pasojat e korrupsionit në shoqëri është i lartë si edhe përfitimet pozitive të shoqërisë, si pasojë e reduktimit të tij.**
3. **Prokuroria e Posaçme konsiderohet si institucion i efektshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar**, por qytetarët kërkojnë të dëgjojnë më shumë rreth punës së saj, për të konsoliduar besimin tek ky institucion.
4. 94% e qytetarëve **e njohin Prokurorinë e Posaçme** dhe 62% **besojnë se institucioni ka qenë i efektshëm** në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

5. Media dhe shoqëria civile në Shqipëri besojnë se Prokuroria e Posaçme mund të jetë më **transparente** kur komunikon punën e saj.
6. Media kërkon të dijë më shumë nga Prokuroria e Posaçme përfshirë informacion të anonimizuar dhe të dhëna mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar.
7. Punonjësit e sektorit publik shprehen se mbulimi për punën e Prokurorisë së Posaçme nga media ka ndihmuar në **reduktimin e sjelljeve korruptive** në institucionet publike.
8. **Besimi publik tek Prokuroria e Posaçme është i lartë**, por besimi apo ndërgjegjësimi lidhur me institucionet e tjera që hetojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar nuk është në standardet e pritshmërisë së publikut.
9. **Njerëzit duan të raportojnë mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar, por nuk kanë informacion të plotë për mënyrën si duhet të veprojnë dhe hezitojnë ta bëjnë pasi ndihen të pasig urt.** Vetëm 11% e të intervistuarve kanë raportuar për korrupsionin, ndërsa 19% kanë konsultuar informacione mbi mënyrën e raportimit të korrupsionit.
10. **Korrupsioni është shqetësim i përditshëm për qytetarët.** Banorët e zonave me nivele të larta të krimit të organizuar nuk ndihen të sigurt. 91% e qytetarëve mendojnë se korrupsioni është ende problem madhor në Shqipëri.
11. Shqiptarët janë gjithnjë dhe më të vendosur për ta sfiduar korrupsionin pasi shohin raportimet në media mbi hetimet e zyrtarëve të lartë.
12. 69% e njerëzve **nuk kanë pranuar të paguajnë ryshfet** për të pasur akses në shërbime publike, të rinjtë, veçanërisht, janë më të prirur të mos e bëjnë.
13. Qytetarët dëshirojnë të shohin **më shumë lajme pozitive për <u>përparimin</u> në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.** Qytetarët raportuan se kanë parë lajme për krimin e organizuar dhe korrupsionin thuajse çdo ditë dhe se janë ndikuar negativisht, gjë që lidhet edhe me zhgënjimin dhe mungesën e shpresës.

PLANI I MASAVE

OBJEKTIV 1: Komunikimet tona duhet të jenë të qarta, të shpejta dhe të kuptohen nga gazetarët dhe qytetarët, për të pakësuar ndikimin e keqinformimit.

Masa 1: Do të përmirësojmë komunikimin e brendshëm për të siguruar planifikimin dhe përgatitjen paraprake nga specialistët e marrëdhënieve me median. Komunikimet do t'u vihen në dispozicion medias në formën e njoftimeve ose deklaratave për shtyp sapo informacioni të kalojë nga prokurorët në gjykatë dhe të jetë çliruar nga sekreti hetimor, në përputhje me ligjin. Kjo do të ndikojë në reduktimin e rrjedhjeve të informacionit dhe do të ndihmojë Prokurorinë e Posaçme të paraqesë informacionin në versionin e saj zyrtar.

Masa 2: Të gjitha komunikimet me aktorët e jashtëm do të kryhen përmes Koordinatorit për Marrëdhënien me Median te Prokurorisë së Posaçme, pasi të kenë marrë aprovimin institucional. Koordinatori do të trajtojë kërkesat e gazetarëve dhe do t'u vë në dispozicion përgjigjen, përfshirë njoftimet për shtyp, deklaratat reaguese, etj. Kushtetuta dhe ligji nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" konsiderohen si bazat themelore ligjore për respektimin e të drejtës të çdo qytetari, për t'u njohur me dokumente zyrtare. Prokuroria e Posaçme harton dhe publikon në faqen online programet e transparencës, regjistrin e kërkesave për informacion dhe përgjigjet duke respektuar afatet e parashikuar në ligj.

Masa 3: Njoftimet për shtyp dhe materialet e tjera do të hartohen në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Të gjitha njoftimet dhe deklaratat për shtyp do të përfshijnë tituj, të cilët përcaktojnë lajmin, akuzat do të shpjegohen qartë, duke parë me vëmendje edhe ndikimin e lajmit tek qytetarët. Termat juridike do të pasqyrohen thjeshtë dhe do të përfshihen vetëm kur shihet e nevojshme.[10]

Masa 4: Do të përdoren mesazhe kyçe për të theksuar qartë përparësitë e Prokurorisë së Posaçme në komunikimet e veta dhe mund të përfshihen edhe citime nga prokurorët e çështjeve për të garantuar llogaridhënien, veçanërisht në çështje të rëndësishme.

Masa 5: Koordinatori për Marrëdhënien me Median do të organizojnë seanca informuese me

[10] Të dhëna më të detajuar për nenet përkatëse te Kodit Penal apo të dhëna të tjera të natyrës teknike ligjore do të përfshihen tek rubrika "shënime për gazetarët" në njoftimet për shtyp.

gazetarët, përmes të cilave do të jepet informacion mbi ecurinë e punës së Prokurorisë së Posaçme.

NJOFTIMET PËR SHTYP

- Në çdo njoftim për shtyp vendosen tituj për përcaktimin e lajmit.
- Në 90% të njoftimeve për shtyp, dy paragrafët e parë shpjegojnë qartë dhe thjesht lajmin dhe veprimet e ndërmarra nga Prokuroria e Posaçme.
- Në çdo njoftim për shtyp përfshihet 1 mesazh kyç.
- Çdo tre muaj përfshihen citime nga Drejtuesi apo prokurorët në përditësimet e njoftimeve, lidhur me çështjet që kanë rëndësi të madhe.

OBJEKTIV 2: Do të respektojmë të drejtat e individëve nën hetim dhe do të punojmë me palët e interesit, gazetarët dhe median, me qëllim zbatimin e proceseve të rregullta ligjore.

Masa 1: Do ta përdorim komunikimin për të informuar në mënyrë të vazhdueshme gazetarët dhe median, qytetarët dhe grupet e interesit lidhur me funksionin e Prokurorisë së Posaçme në sistemin e drejtësisë, e cila angazhohet të ruajë të drejtën për të pasur një proces të paanshëm hetimor.

Masa 2: Komunikimet publike do të kryhen vetëm në rastet e parashikuara nga ligji për të mos lëkundur/cënuar sekretin hetimor dhe procesin e rregullt ligjor. Përditësimet do t'i komunikohen medias në rastin më të parë sipas fazës së procesit të gjykimit.

Masa 3: Do të kryhen përditësime me të dhëna, mbi çështjet e SPAK, të cilat do të lidhen kryesisht me ecurinë e tyre, sipas fazës së hetimeve paraprake apo gjykimit. Këto informacione do t'u shërbëjnë gazetarëve/medias, qytetarëve dhe grupeve të interesit.

OBJEKTIV 3: Kanalet e komunikimit të SPAK do të kthehen në një burim të besueshëm për qytetarët me informacione dhe të dhëna të përditësuara.

Masa 1: Komunikimet ndahen në faqen e internetit të SPAK-ut dhe u vihen në dispozicion gazetarëve dhe medias, qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Masa 2: Prokuroria e Posaçme do të **zbatojë Strategjinë për Median Sociale** duke postuar në mënyrë të rregullt, me qëllimin që këto kanale të zhvillohen dhe të kthehen në burime të drejtpërdrejta dhe të besueshme informimi për qytetarët.

Masa 3: Çdo vit, SPAK do të paraqesë të dhëna mbi tendencat e krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Masa 4: Materialet e komunikimit do të draftohen me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, për t'u lexuar e kuptuar lehtësisht nga qytetarët.

OBJEKTIV 4: Qytetarët do të kenë qasje në informacionin e shpejtë zyrtar, të publikuar në rrjetet sociale dhe faqen e internetit të SPAK

Masa 1: Prokuroria e Posaçme do të përdorë një mekanizëm të brendshëm të komunikimit, ku parashikohen datat për përditësimet e hetimeve, në mënyrë që Koordinatori për Marrëdhënien me Median të ketë me shumë kohë në dispozicion për të hartuar njoftimet për shtyp.

Masa 2: SPAK do të publikojë deklarata zyrtare brenda një kohe të shpejtë, pas daljes në media të informacioneve mbi një çështje të caktuar.

Masa 3: Qytetarët dhe palët e interesit do të kenë qasje në komunikimet e Prokurorisë së Posaçme, në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale, për t'u informuar për çështje të caktuara për aq sa e lejon ligji.

Masa 4: SPAK do të zhvillojë konferenca për shtyp, intervista dhe njoftime lidhur me çështje me interes të lartë publik, me qëllim ndarjen e informacionit mbi çështjen.

OBJEKTIV 5: Ne do të ndajmë në kohë informacionin dhe do të angazhohemi për të përmirësuar standardet e komunikimit lidhur me raportimet mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar, për të ndihmuar qytetarët të mirëinformohen rreth rolit të SPAK.

Masa 1: Do të publikojmë **të dhëna** çdo 3 mujor duke dhënë hollësi mbi numrin e procedimeve të reja penale, çështje të përfunduara hetimore, pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara etj. Këto informacione do të publikohen në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale duke informuar njëherësh gazetarët, median, qytetarët dhe palët e interesit.

Masa 2: Çdo tre mujor do të organizojmë një komunikim përmbajtësor të nivelit të lartë, me qëllim ndarjen e informacionit dhe të dhënave statistikore (njoftime për shtyp, fjalime, evente dhe intervista).

Masa 3: Do të japim kontribut në fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë duke

ndarë njohuritë, instrumentet dhe praktikat tona më të mira. Këtu përfshihet organizimi i aktiviteteve, tryezave të rrumbullakëta dhe diskutimeve për të bashkëpunuar dhe për të përcaktuar synimet e përbashkëta për përmirësimin e shtetit të së drejtës dhe zbatimin e ligjit.

OBJEKTIV 6: Do të jemi të qartë për mënyrat si qytetarët mund të sjellin çështjet e tyre në SPAK dhe çfarë mund dhe nuk mund të hetojmë, me qëllim menaxhimin e pritshmërisë dhe ruajtjen e besimit të tyre.

Masa 1: SPAK do të japë informacion të qartë në faqen zyrtare, ku do të shpjegojë se cilat çështje mund dhe nuk mund të hetohen dhe mënyrat si qytetarët mund të raportojnë mbi ato raste që mund të pranohen në Prokurorinë e Posaçme.

Masa 2: Në faqen e internetit të Prokurorisë së Posaçme do të krijohet një kategori e dedikuar për "***Pyetjet më të Shpeshta***", të cilat do të ndihmojnë qytetarët të jenë të informuar për çështjet e trajtuara nga SPAK.

Masa 3: Përmes rrjeteve tona sociale do të ndajmë informacion lidhur me llojet e çështjeve të trajtuara nga Prokuroria e Posaçme.

OBJEKTIV 7: Do të komunikojmë në mënyrë proaktive dhe të rregullt dhe do të jemi një burim i besuar informacioni, duke reduktuar ndikimin e narrativave të dëmshme mediatike dhe keqinformimin.

Masa 1: Miratimi i **Protokollit të Komunikimit gjatë Krizave, një dokument tashmë i hartuar dhe i ndarë brenda institucionit** do të shërbejë për të menaxhuar çështje, si dhe të parandalojë përballjen me situata krize. Ky protokoll do të ndihmojë në shmangien e dëmeve afat-gjata që lidhen me funksionin dhe reputacionin e Prokurorisë së Posaçme, në mënyrë që ky institucion të konsolidojë besimin e qytetarëve shqiptarë.

Masa 2: Monitorimi i mediasdo të ndihmojë në identifikimin e keqinformimit, si dhe në korrektimin e raportimeve faise dhe kjo do të kryhet përmes deklaratave në media, njoftimeve për shtyp, apo duke zhvilluar seanca informuese me gazetarët.

Masa 3: Ne do të jemi të pranishëm gjatë situatave të krizave dhe do t'i përditësojmë qytetarët mbi zhvillimet e fundit. Këtu përfshihet organizimi i seancave informuese me median, konferencave për shtyp, si edhe publikimi i njoftimeve në rrjetet tona sociale.

OBJEKTIV 8: Do të monitorojmë dhe vlerësojmë efektshmërinë e komunikimeve dhe do të vëmë në zbatim mësimet e nxjerra.

Masa 1: Monitorimi dhe vlerësimi i efektshmërisë së komunikimeve të SPAK-ut do të kryhet përmes analizës së raportimeve në media. Nga narrativa e reflektuar do të vlerësohet nëse këto komunikime kanë ndikim në shoqëri.

Masa 2: Do të kryejmë anketime 3 (tre) mujore me gazetarët dhe median për të parë efikasitetin e mënyrës së komunikimit. Rezultatet do të ndahen me Drejtuesin, prokurorët e posaçëm dhe hetuesit.

Masa 3: Analiza e rrjeteve sociale do të jetë e vazhdueshme, përmes saj do të kuptojmë edhe nivelet e angazhimit dhe opinionet, të cilat do të ndahen me Drejtuesin dhe prokurorët e posaçëm, çdo tre muaj. Kjo do të sigurojë edhe informacionin e nevojshëm për llojin e përmbajtjes, që angazhon qytetarët dhe palët e interesit.

STANDARDET DHE PLANI I ZBATIMIT

1. Informacionet e qytetarëve, grupeve të interesit dhe medias do të na ndihmojnë të kuptojmë nevojat e komunikimit për audiencat e ndryshme dhe perceptimin e tyre mbi funksionet e SPAK dhe veçanërisht, çasjes në komunikim. Gjithashtu, kjo do të lehtësojë analizën tonë për mundësitë dhe pengesat që hasin qytetarët dhe punonjësit e sektorit publik për të raportuar korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe për të ndryshuar sjelljen.

2. Datat e përafërta të çështjeve të pritshme (për shembull urdhër-arreste, masa sigurie) përfshihen në dokumentin e planifikimit të komunikimit të brendshëm, duke i dhënë Koordinatorit për Marrëdhënien me Median dhe ekipit mbështetës kohën e mjaftueshme për hartimin e komunikimeve të qarta dhe të shpejta, të cilat do të ndahen me qytetarët dhe median. Datat e përafërta të shënuara në dokumentin e planifikimit të komunikimit të brendshëm duhet të rishikohen një herë në javë.

3. Koordinatori për Marrëdhënien me Median mund të marrë pjesë në takimet e punës së prokurorëve dhe hetuesve, në të cilat nuk cënohet sekreti hetimor, në takimet me stafin administrativ për të rekomanduar dhe zhvilluar trajnime kur paraqitet e nevojshme në lidhje me komunikimin me publikun, me fokus çështjet që përbëjnë rëndësi të veçantë për publikun.

4. Kërkesat për informacion nga gazetarët dhe media, përfshirë edhe ato për intervista dhe komente për çështje të caktuara, trajtohen nga Koordinatori për Marrëdhënien me Median në Prokurorinë e Posaçme. Ligji nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" konsiderohet si një nga zhvillimet më të rëndësishme për respektimin e të drejtës të çdo qytetari për t'u njohur me dokumente zyrtare. Institucioni i Prokurorisë së Posaçme harton dhe publikon në faqen e saj programet e transparencës, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve për informacion.

5. Të gjitha materialet për gazetarët dhe median, apo ato që do të postohet në rrjetet tona sociale Facebook [Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar], X [@SPAK_Albanian] **përgatiten paraprakisht nga Koordinatori për Marrëdhenien me Median**, duke siguruar që të jenë të qarta dhe të kuptueshme lehtësisht nga qytetarët, gazetarët dhe grupet e interesit.

6. Njoftimet për shtyp u dërgohen mediave dhe grupeve të interesit **njëherësh** me avancimin e çështjes, për të reduktuar mosinformimin ose keqinformimin. Kjo do të bëjë të mundur që narrativa e parë në media për të cilën do të mësojnë qytetarët do të jenë masat e marra nga Prokuroria e Posaçme, duke ruajtur autoritetin dhe pavarësinë e institucionit.

7. Prokuroria e Posaçme do të bëjë **deklaratë zyrtare** sa më shpejt të jetë e mundur pas raportimit të lajmit në media, në kanalet zyrtare, përfshirë edhe mediat sociale.
8. Qytetarët dhe palët e interesit do të kenë **qasje në informacionin zyrtar të publikuar** në kanalet e mediave sociale dhe në faqen e internetit të institucionit sa më shpejtë të jetë e mundur pas publikimit të tij në media.

9. Do të organizojmë **seanca informuese çdo tre muaj për median**, me qëllim informimin mbi progresin e çështjeve me interes të lartë publik si dhe vështirësitë e hetimit të tyre, pa cënuar sekretin hetimor.

10. Koordinatori për Marrëdhënien me Median dhe stafi mbështetës do të trajnohen **nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë.**

11. **Ne do të komunikojë shpejt me qytetarët, median dhe grupet e interesit gjatë krizave**, me qëllim ruajtjen e besimit tek Prokuroria e Posaçme dhe shmangien e përhapjes së keqinformimit.

12. Komunikimet do te **monitorohen dhe vlerësohen** për të përcaktuar efektshmërinë e tyre tek gazetarët, media, qytetaret dhe grupet e interesit. Analiza i vihet në dispozicion Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Drejtorit të Kabinetit, këshilltarëve juridikë dhe 19 prokurorëve të posaçëm, çdo tre muaj.

13. **Raporti i progresit mbi zbatimin e kësaj Strategjie Komunikimi** dhe përparimi drejt përmbushjes së Treguesve Kyç të Performancës (TKP-ve) do të ndahet brenda institucionit, me Kuvendin dhe donatorët përkatës çdo gjashtë muaj.

14. Prokuroria e Posaçme do të publikojë **raporte progresi dhe informacione** operacionale të anonimizuara çdo tre mujor, duke paraqitur me hollësi numrin e procedimeve të reja penale, çështjet në hetim e sipër, çështjet e përfunduara, pasuritë e sekuestruara dhe të konfisikuara etj. Këto do të publikohen në faqen e internetit dhe në media sociale dhe do të ndahen me gazetarët, median dhe palët e interesit.

15. Prokuroria e Posaçme do të hartojë **udhëzime të qarta për qytetarët**, ku shpjegohet se cilat çështje mund dhe nuk mund të hetohen dhe mënyrat si qytetarët mund të raportojnë mbi fenomene që lidhen me Korrupsionin, Krimin e Organizuar dhe Terrorizmin.

16. Planet e komunikimit dhe të angazhimit tonë **do të bazohen dhe do t'u përgjigjen informacioneve të qytetarëve, gazetarëve dhe grupeve të interesit** përfshirë reagimet e tyre kundrejt komunikimeve tona.

17. Komunikimi dhe angazhimi i Prokurorisë së Posaçme do të **përshtatet sipas nevojave të llojeve**

Adresa: Rruga "Jordan Misja" nr.1 Tiranë Website: www.spak.gov.al

të ndryshme të audiencës, përfshirë ato në zona rurale, jashtë Tiranës si; gratë, pakicat dhe komunitetet të prekura nga krimi i organizuar dhe korrupsioni. Për shembull, SPAK-u do të angazhohet me grupet lokale të interesit dhe median lokale për ofrimin e materialeve të komunikimit në gjuhët e pakicave, aty ku kjo është e nevojshme.

MONITORIMI DHE VLERESIMI

1. Prokuroria e Posaçme do të përditësojë zbatimin e kësaj strategjie bazuar në Treguesit Kyç të Performancës duke i raportuar Kuvendit dhe donatorëve çdo vit dhe do të publikojë përditësime tre mujore në faqen e internetit të institucionit.

2. Çdo tre muaj do të kërkohet edhe reagimi i një grupi gazetarësh, të cilët përfaqësojnë panoramën e larmishme mediatike në vend.

3. Angazhimi dhe gjykimet e qytetarëve do të monitorohen përmes mediasë sociale.